

ked



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 1023/prot.

Tiranë, më 05.122025

2

VENDIM  
Nr. 62, datë 05.12.2025

PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 45, DATË 27.7.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 45, datë 27.7.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Peqin dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë",

**KONSTATOVA SE:**

Me urdhrin nr. 39 (223 prot.), datë 21.3.2024, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil në Bashkinë Peqin", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira dhe procedurave disiplinore në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, në institucionin Bashkia Peqin.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 45, datë 27.07.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Peqin dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë", ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e këtij vendimi, në institucionin Bashkia Peqin, me urdhrin nr. 132, datë 20.12.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 45, datë 27.07.2024. të Komisionerit”*, sipas objektit dhe drejtimeve që përmban programi i mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij urdhri. Për nisjen e këtij procesi Bashkia Peqin është njoftuar me shkresën nr. 954/2 prot., datë 20.12.2024, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit paralajmërues nr. 45, datë 27.7.2024, të Komisionerit”*.

Mbikëqyrja në subjekt u krye në datat 13-24 janar 2025. Në përfundim të procesit, grupi i punës mbajti një procesverbal, ku u evidentua situata në lidhje me ecurinë e masave të marra nga institucioni. Konkretisht, rezultoi se pikat 2, 3 dhe 6 të vendimit paralajmërues ishin zbatuar plotësisht, ndërsa pikat 4 dhe 5 të tij ishin zbatuar pjesërisht, vërtetuar kjo me dokumentacionin përkatës të administruar nga grupi i punës.

Në vijim, duke pasur parasysh një sërë problematikash objektive dhe subjektive që hasen gjatë administrimit të shërbimit civil, sidomos në rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin dhe zbatimit të institutit të rekrutimit në shërbimin civil, me qëllim shterimin e të gjitha masave për arritjen e zbatimit të vendimit paralajmërues, si dhe për të dëgjuar arsyet e mosveprimit në kohë nga ana e institucionit, Komisioneri me anë të urdhrit nr. 51, datë 18.06.2025, urdhëroi që, procesi të vijojë me zhvillimin e një seance dëgjimore me Kryetarin e Bashkisë ose përfaqësues të caktuar prej tij dhe drejtuesit e njësisë përgjegjëse (*njësia së menaxhimit të burimeve njerëzore*) të institucionit.

Seanca u zhvillua në datën 23.06.2025, në ambientet e Komisionerit, me pjesëmarrjen e Drejtorit dhe Specialistes së Burimeve Njerëzore të institucionit. Në lidhje me detyrat e vendimit paralajmërues, të cilat kishin mbetur të pazbatuara, nga analiza e dokumentacionit të paraqitur dhe nga sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, u konstatua se institucioni ka ndërmarrë disa veprime të tjera për rregullimin e ligjshmërisë, por sërish, një pjesë e tyre rezultuan të pazbatuara. Konkretisht, nuk ishin marrë masat e nevojshme administrative për korrigjimin e 11 emërimeve të kryera në kundërshtim me ligjin, ashtu siç do të evidentohet gjatë shqyrtimit të hollësishëm të secilës pikë të dispozitivit të vendimit paralajmërues.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 45, datë 27.07.2024, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Kryetari i Bashkisë dhe njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, konstatohet se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Peqin, paraqitet si më poshtë vijon:

Për sa i përket **pikës 2** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga institucioni të rregullojë ligjshmërinë në lidhje me punonjësen L. Kateshi; konkretisht, njësia përgjegjëse të kryejë verifikimin e dokumentacionit që vërteton plotësimin e kërkesave të nivelit arsimor në përputhje me përkrahimin e vendit të punës. Në rast se nga verifikimi rezulton se punonjësja nuk i plotëson kërkesat e posaçme të nivelit arsimor, njësia

përgjegjëse duhet të veprojnë në përputhje me përcaktimet e neneve 21 dhe 65 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Nga dokumentacioni i administruar vërej se, për zbatimin e kësaj detyre, njësia përgjegjëse, me shkresën nr. 1254 prot., datë 26.06.2024, ka njoftuar punonjësen për domosdoshmërinë e plotësimit të dokumentacionit që provon përmbushjen e kërkesave të nivelit arsimor. Paralelisht, Bashkia Peqin i është drejtuar zyrtarisht, me anë të postës elektronike, Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë, i cili ka konfirmuar se L.Kateshi nuk e ka përfunduar ciklin e parë të studimeve, por vijon ende vitin e tretë në këtë fakultet.

Në vijim, njësia përgjegjëse ka ndërmarrë masat administrative për rregullimin e ligjshmërisë. Me Urdhrin nr. 1942/1 prot., datë 10.10.2024, "Për emërim në detyrë", punonjësja L. Kateshi është emëruar në një pozicion tjetër jashtë shërbimit civil, konkretisht në Sektorin e Shërbimit me një Ndalesë.

Në pikën 3 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar përmbylljen e procesit të konfirmimit si nëpunës civil, pas përfundimit të afatit të periudhës së provës, për nëpunësit A. Lluca dhe I. Daka, të cilët janë emëruar nëpunës civil në periudhë prove në përputhje me kërkesat ligjore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatoj se njësia përgjegjëse e Bashkisë Peqin, në vijim të zbatimit të kësaj detyre dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e lëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ka nxjerrë aktet për deklarimin e statusit të punësimit si vijon:

- Me aktin nr. 2550 prot., datë 31.12.2024, znj. A. Lluca është konfirmuar si nëpunëse civile në pozicionin "Specialist" pranë Sektorit të Aplikimit të Projekteve dhe Integritetit Evropian;
- Me aktin nr. 1084 prot., datë 03.06.2024, z. I. Daka është konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin "Specialist" pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe TIK.

Sa më sipër, vlerësoj se pika 3 e vendimit paralajmërues është zbatuar plotësisht.

Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Peqin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të **18** (tetëmbëdhjetë) akteve të emërimit të punonjësve të cilët janë emëruar në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj.

Në lidhje me zbatimin e kësaj detyre, konstatoj se me shkresën nr.1568/1/2/3/4/6/7/8/9/10/11/14/15/16 prot., datë 12.08.2024, "Dërgohet për njoftim vendimi paralajmërues nr. 223/5 prot., datë 24.7.2024 i KMSHC, me të cilin kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë absolute të akteve të emërimit për punonjësit të emëruar në

pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, njoftimi për nisjen e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për këtë shkak”, Kryetari i Bashkisë Peqin ka njoftuar nominalisht punonjësit e ciftuar në pikën 4 të vendimit nr.45/2024, duke i informuar për situatën e paligjshmërisë në të cilën ndodhen marrëdhëniet e tyre të punësimit, si dhe për masat që do të ndërmerren në kuadër të zbatimit të kërkesës për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të emërimit, sipas kërkesave të vendimit paralajmërues.

Nga verifikimi në subjekt i kryer gjatë periudhës 13–24 janar 2025, rezultoi se njësia përgjegjëse ka ndërmarrë masa konkrete vetëm për një pjesë të rasteve, duke rivendosur gjendjen e ligjshmërisë dhe duke siguruar fillimin e procedurave të rekrutimit, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë institut.

Në kuadër të veprimeve të ndërmarra, vërejt se:

- Me Urdhrin nr. 118, datë 22.04.2024, punonjësi E. Dushku është liruar nga pozicioni “*Specialist*” në Sektorin e Koordinimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj dhe është emëruar në një pozicion jashtë administrimit të shërbimit civil.
- Me Urdhrin nr. 264, datë 01.09.2024, punonjësi A. Çullhaj është emëruar në pozicionin “*Agjent Tatimor*”, jashtë shërbimit civil; ndërkohë, pozicioni i mëparshëm “*Inspektor*” i Taksave dhe Tarifave Vendore është shpallur vakant.
- Me miratimin e strukturës së re, përmes VKB nr. 38, datë 27.09.2024, është rregulluar situata e paligjshmërisë për punonjësin A. Canaku, i cili mbante pozicionin “*Drejtor*” në Drejtorinë e Mirëqenies dhe Kujdesit Social, si dhe për punonjësen E. Juba, në pozicionin “*Specialist Jurist*” pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike, pasi tashmë marrëdhëniet e punës në këtë drejtori rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
- Për punonjësen M. Sulkja, me Urdhrin nr. 28, datë 22.01.2025, “*Për zgjidhjen e kontratës së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare*”, është vendosur ndërprerja e marrëdhënies së punës nga pozicioni “*Specialist për Menaxhimin e Performancës*” Sektori i Performancës në Njësinë e Integritimit Evropian, Projekteve, Performancës dhe Diasporës.

Sipas procesverbalit të mbajtur gjatë verifikimit në subjekt në datat 13-24.01.2025, në rubrikën “*Qëndrimi i institucionit*”, njësia përgjegjëse ka deklaruar se, pas miratimit të strukturës së re për vitin 2025 dhe pas dërgimit të saj tek Prefekti i Qarkut Elbasan, aktet përfundimtare për materializimin e zbatimit të kësaj pike do të dërgohen me postë elektronike. Në vijim të këtij deklarimi, në datën 10.02.2025, Bashkia Peqin ka dërguar të skanuar shkresën nr. 188 prot., datë 24.01.2025, drejtuar AKPA-së, për publikimin e Vendimit nr. 33, datë 24.01.2025, “*Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil në Bashkinë Peqin për vitin 2025*”, në të cilin janë parashikuar 25 vende

të lira për t'u plotësuar përmes procedurave të pranimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Më tej, njësia përgjegjëse ka përcjellë me e-mail më 3 nëntor 2025 disa akte që materializojnë masat e mëtejshme që janë marrë për zbatimin e kësaj pike të vendimit. Konkretisht, konstatohet se:

- Me urdhrin nr. 319, datë 24.9.2025, punonjësi A.Kosta është liruar nga pozicioni që mbante në shërbimin civil si "*Specialist Prokurimi në Sektorin Juridik*" dhe është emëruar në një pozicion jashtë administrimit të shërbimit civil.
- Me urdhrin nr. 263, datë 14.8.2025, "*Për plotësimin e vendeve të lira dhe mënyrën e rekrutimit*", të Sekretarit të Përgjithshëm, ka filluar procedura për lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil për pozicionin "*Specialist për mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik*".
- Me aktin nr. 773 prot., datë 16.4.2025, pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, në pozicionin "*Specialiste Inventari*", është emëruar Z. Manahasa.
- Me aktin nr. 774 prot., datë 16.4.2025, pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, në pozicionin "*Arkitekte*" në Sektorin e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, është emëruar E. Meta.

Në përfundim të vlerësimit të kryer, vlerësoj se institucioni ka ndërmarrë veprime të plota për rivendosjen e ligjshmërisë vetëm në 8 nga 18 rastet e konstatuara si të paligjshme.

Në pikën 5 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Peqin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit nr. 447/3 (447/3 prot.), datë 04.03.2024, si një akt i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në veçanti me rregullimin ligjor për ngritjen në detyrë. Gjithashtu, është kërkuar që punonjësja A. Dehima të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës, ose, nëse rikthimi nuk është i mundur për arsye objektive, të sistemohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, për të cilin ajo plotëson kërkesat specifike.

Nga analiza e dokumentacionit dhe verifikimeve të kryera në subjekt, vërej se kjo pikë e vendimit mbetet e pazbatuar. Pavarësisht njoftimit të punonjësës mbi gjetjet dhe detyrimet e përcaktuara në vendimin nr. 45/2024 të Komisionerit, siç dokumentohet në procesverbalin e mbajtur gjatë mbikëqyrjes në institucion, Kryetari i Bashkisë Peqin nuk ka ndërmarrë asnjë masë konkrete për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit nr. 447/3, datë 04.03.2024, dhe as për rikthimin e punonjësës në pozicionin e saj të mëparshëm të punës. Referimi i njësisë përgjegjëse se dokumentacioni provues do të paraqitet pas miratimit të strukturës organizative për vitin 2025 nuk përbën zbatim të kësaj kërkesë të vendimit, duke e lënë këtë detyrim plotësisht të papërmbyshur.

Në **pikën 6** të vendimit paralajmërues, njësisë përgjegjëse i është kërkuar të plotësojë mangësitë e konstatuara gjatë verifikimit të akteve të depozituara në dosjet personale të nëpunësve civilë.

Në zbatim të kësaj detyre, me shkresat nr. 1567/18/19/21 prot., datë 12.08.2024, konstatohet se janë njoftuar nëpunësit Xh. Lundraxhiu, E. Lluca, A. Dehima dhe M. Plaku për dorëzimin e kopjeve të diplomës dhe listës së notave. Nga verifikimi rezultoi se dokumentacioni i kërkuar është dorëzuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe është administruar në dosjet personale përkatëse.

Lidhur me rastet e evidentuara si mungesa të raporteve mjekësore, grupi i verifikimit ka përzgjedhur në mënyrë rastësore disa dosje personale, për të kryer një kontroll të mëtejshëm. Nga kjo këqyrje është konstatuar se raportet mjekësore ishin depozituar në dosjet e nëpunësve të listuar në anekset e bashkëlidhura me raportin e mbikëqyrjes, duke konfirmuar se mangësitë e evidentuara më herët janë plotësuar.

**Në përfundim**, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, vlerësoj se Bashkia Peqin ka zbatuar vetëm pjesërisht rekomandimet e përcaktuara në Vendimin Paralajmërues nr. 45, datë 27.07.2024, të Komisionerit.

Sa i takon aspektit më problematik që ka të bëjë me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, vlen të theksohet se nga institucioni ka filluar të merren masa, duke u dërguar njoftimet përkatëse të gjithë punonjësve të emëruar në kundërshtim me legjislacionin për nëpunësin civil, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Megjithatë, ky proces kërkon një periudhë kohore të domosdoshme përtej afatit paralajmërues të përcaktuar nga Komisioneri, pasi po realizohet pjesë-pjesë, me qëllim që të mos pengohet funksionimi normal i institucionit.

Ky arsyetim mbështetet edhe në faktin se të gjitha pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin janë përfshirë në planin e rekrutimit, me synim plotësimin e tyre në përputhje të plotë me procedurat ligjore.

Në këto kushte, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

## VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 45, datë 27.07.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Peqin dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë".
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Peqin.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



